REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KESHILLI BASHKIAK

**KOMISIONI I FINANCAVE, EKONOMISE DHE PASURIVE PUBLIKE VENDORE**

RAPORT VENDIMARRJE

Nr. 22,     Datë 28/ 05/ 2026

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr........datë, ......./......../2026 *"Per miratimin e tavaneve te programit buxhetor afatmesem (PBA) 2027-2029"*

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Gramsh

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga *Drejtoria e Finances dhe Buxhetit*, dhe ka për qëllim:

| | |
|---|---|
| BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI | *Projekt vendimi mbeshtetet në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", neni 41 pika 1, neni 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; neni 36 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore"; ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit"; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV", Udhëzim plotësues nr. 07 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029" me shtojcat plotesuese, si dhe materialin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Gramsh.* |
| SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT | *Percaktimi i tavaneve buxhetore brenda mundesive financiare pasqyron kerkesat e qytetareve. Persa i perket listes se prioriteteve per projekt buxhetin afatmesem 2027-2029, investiemt per tre vitet e ardheshme do te rriten dhe do te fokusohen per Sistemim Asfaltim, Rikonstruksione Rruge, Ura, Shkolla, Ambjenteve Kulturore dhe Sportive.*<br>*Bashkia ka konsideruar strukturen e programeve duke siguruar perfshirjen brenda nje programi shpenzimesh te funksioneve kryesore te njesise.*<br>*Gjithashtu, eshte zhvilluar diskutimi GSM me drejtuesit e programeve per dokumentin e reziqeve te* |

| | |
|---|---|
| | *paraqitura prej tyre. Eshte bere shperndarja tek cdo ekip EMP i udhezimit te brendshem nga titullari ne lidhje me zbatimin e procedurave te programit buxhetor afatmesem. Jane nenshkruar te gjitha raportet e pergatitjes se kerkesave buxhetore per perdorim te brendshem te njesise ne lidhje me rishikimin e politikes se programit dhe planifikimit te shpenzimeve te programit. Eshte bere prezantimi i GSM te gjitha dokumentave te kerkesave buxhetore prane Kryetarit te Bashkise.* |
| SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet) | *- Të ardhurat e veta vendore per vitet 2027-2029, zënë mesatarisht 16.5% të totalit të buxhetit.*<br>*- Transferta e pakushtëzuar per vitet 2027-2029, zënë mesatarisht 47.5% të totalit të buxhetit.*<br>*- Transferta e pakushtëzuar sektoriale per vitet 2027-2029 zë mesatarisht 28.8% të totalit të buxhetit.*<br>*- Burimet nga te ardhurate trasheguara qe parashikohet per vitet 2027-2029 zë mesatarisht 7,2% të totalit të buxhetit.*<br>*<u>Totali i te ardhurave:</u>*<br>*2027-816,928 mije leke, 2028-834,511 mije leke, 2029-854,460 mije leke*<br>*- Totali i shpenzimeve te personelit per vitin 2027 është 414,659 mijë lekë dhe zë 50.8% të totalit të shpenzimeve, per vitin 2028 është planifikuar 414,659 mijë lekë dhe ze 49.7% te shpenzimeve dhe per vitin 2029 është planifikuar 422,973 mijë lekë dhe ze 50.0% të totalit të shpenzimeve.*<br>*- Totali i shpenzimeve operative per vitin 2027 është 241,245 mijë lekë mesatarisht 29.5% të totalit të shpenzimeve, per vitin 2028 është planifikuar 244,999 mijë lekë mesatarisht 29.4% të totalittë shpenzimeve dhe per vitin 2029 është planifikuar 248,870 mijë lekë dhe zënë mesatarisht 29.1% të totalit të shpenzimeve*<br>*- Totali i shpenzimeve kapitale per vitin 2027 është planifikuar 161,024 mijë lekë mesatarisht zene 19.7% te shpenzimeve, per vitin 2028 jane planifikuar174,853 mijë mesatarisht zene 21.0% lekë dhe ne vitin 2029 jane planifikuar 182,617 mijë lekë, mesatarisht zene 20.7% te shpenzimeve*<br>*- <u>Totali i shpenzimeve:</u>* |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KESHILLI BASHKIAK

**KOMISIONI I FINANCAVE, EKONOMISE DHE PASURIVE PUBLIKE VENDORE**

| | |
|---|---|
| | *2027-816,928 mije leke, 2028-834,511 mije leke, 2029-854,460 mije leke* |
| DREJTORIA PËRGJEGJËSE | *Drejtoria e Finances dhe Buxhetit* |
| RAPORTIMI DHE MONITORIMI | *Administrata e Bashkise do te beje raportimin per Keshilli Bashkiak sipas te gjithe kalendarit te procesit te hartimit te PBA 2027-2029 deri ne miratimin ne tij ne fund te vitit 2026.* |
| IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN | *Ne tavanet buxhetore 2027-2029 jane konsideruar dhe adresohen te gjitha ceshtjet sociale te komunitetit, vecanerisht per komunitetin Egjiptian dhe Rom, personat me aftesi te kufizuara, pensionistet, personat me semundje te renda etj.* |
| KONSULTIMI PUBLIK | *Konsultimet publike per tavanet buxhetore 2027-2029 do te behen ne muajin Maj 2026* |

Komisioni i Përhershëm i Financave, Ekonomise dhe Pronave Publike Vendore, i mbledhur më datën 28.05.2026 pasi shqyrtoi Projekt-vendimin *"Per miratimin e tavaneve te programit buxhetor afatmesem (PBA) 2027-2029"* relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:

a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.

**b. Miratimin e projektaktit**

Kryetare e Komisionit: Alfrida Shahini

Nenkryetar i Komisionit: Erald Çarçiu

Sekretar i Komisionit: Kujtim Brahimi

Anetar i Komisioni: Ramazan Braho

Anetare e Komisionit: Erisa Zogu